



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.737/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada- Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtar si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me apelin e Besa Ismaili Ahmeti, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Besa Ismaili Ahmeti,, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Prishtinë.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimin për kandidatin për anëtar të Kuvendit Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Prishtinë, në Qendrat e Votimit: 1707c në komunën Pejë, 0308e në komunën Glllogoc, 1129b, 1102b, 1102x, 1103b, 1104b, 1114b në komunën Mitrovica Jugore, 2722b në komunën Vushtrri, 0507a, 0511a, 0512a në komunën Dragash, 0306e në komunën Glllogoc, 2106b, 2125b, në komunën Skenderaj.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 05.03.2021, nga Besa Ismaili Ahmeti, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se lista e komisionerëve sipas vendvotimeve nuk perputhen me gjendjen faktitike për vota, për arsyeje se në vendvotimet 1707c në komunën Pejë, 0308e në komunën Glllogoc, 1129b, 1102b, 1102x, 1103b, 1104b, 1114b në komunën Mitrovica Jugore, 2722b në komunën Vushtrri, 0507a, 0511a, 0512a në komunën Dragash, 0306e në komunën Glllogoc, 2106b, 2125b, në komunën Skenderaj, kam vota më shumë sipas familjarëve dhe miqve që kam në këto qendra të votimeve, dhe kërkon rinumërimin e këtyre vendvotimeve.

Në përgjigjen në ankesë të datës 05.03.2021, të KQZ-së, ndër të tjera thekson se Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palëve ankuese, në lidhje me ankesën Anr.737/2021, njofton se Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka përfunduar procesin e punës si dhe futjen e të dhënave, skanimin e materialeve zgjedhore, verifikimi, hetimin, e formularëve të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, formularët e rezultateve, të kandidatëve FRK, procese këto që mundësojnë evitimin e çdo gabimi teknik dhe jo relevant. Në bazë të Rregullës Zgjedhore, Nr.06/2013, secili formular i rezultateve, para se të filloj të procedohet, i nënshtrohet procesit të auditimit në QNR, gjatë të cilit proces

krahasohen votat e subjekteve me votat e kandidatëve. Nga auditimi që i është bërë formularëve të rezultateve, rezulton se ka pasur probleme, të mos shënimit të saktë në kuptimin teknik të votave të subjekteve. Kur krahasohet me votat e kandidatëve, rezulton se kandidatët kanë vota, por subjekti nuk ka vota dhe ka raste kur subjekti ka vota ndërsa kandidatët nuk kanë vota. Procedura në QNR, nuk lejon asnjë Formular të kaloj, nëse nuk përputhet me votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota atëherë formulari nuk procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatja për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Besa Ismaili Ahmeti, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve 1707c në komunën Pejë, 0308e në komunën Glllogoc, 1129b, 1102b, 1102x, 1103b, 1104b, 1114b në komunën Mitrovica Jugore, 2722b në komunën Vushtrri, 0507a, 0511a, 0512a në komunën Dragash, 0306e në komunën Glllogoc, 2106b, 2125b, në komunën Skenderaj, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 737/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.